



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

**AKT NORMATIV**

Nr. 2, datë 2.10.2019

**PËR**

**DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.99/2018, "PËR BUXHETIN E VITIT 2019"**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr.99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", bëhen këto ndryshime:

**Neni 1**

Nenet 2, 3, 4, 5 dhe 8 ndryshohen, si më poshtë vijon:

**"Neni 2**

Buxheti i shtetit për vitin 2019 është:

Të ardhurat	361 945	milionë lekë;
Shpenzimet	394 845	milionë lekë;
Deficiti	32 900	milionë lekë.

**Neni 3**

Buxheti vendor për vitin 2019 është:

Të ardhurat 55 286 milionë lekë;

Nga të cilat:

- transferta e pakushtëzuar nga buxheti qendror 17 632 milionë lekë;

- transferta specifike	7 443 milionë lekë;
- të ardhura të tjera	30 211 milionë lekë.
Shpenzimet	55 286 milionë lekë.

#### Neni 4

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2019 është:

##### 1. Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror

Të ardhurat, gjithsej,	126 244 milionë lekë;
Nga të cilat:	
- kontributet	82 896 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	41 038 milionë lekë;
- transferta nga buxheti për indeksimin e pensioneve	2 310 milionë lekë;
Shpenzimet	126 244 milionë lekë.

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, është e barabartë me pagën minimale në shkallë vendi dhe ndryshon sa herë që ndryshon kjo pagë. Këshilli i Ministrave përcakton masën e kontributit për personat e vetëpunësuar në bujqësi si dhe të kategorive të veçanta të personave të vetëpunësuar, duke mbuluar nga buxheti i shtetit diferencën midis këtyre kontributeve me masën e kontributit të përcaktuar për personat e vetëpunësuar në qytet. Për vitin 2019, teprica ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas degëve të sigurimit shoqëror dhe programeve të tjera të veçanta e suplementare, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

##### 2. Skema e sigurimit suplementar

Të ardhurat, gjithsej,	5 844 milionë lekë;
Nga të cilat:	
- kontributet	1 446 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	4 258 milionë lekë;
- fondi për indeksimin e pensioneve	140 milionë lekë;
Shpenzimet	5 844 milionë lekë.

Fondi për indeksimin e pensioneve është 2 450 milionë lekë. Përdorimi i këtij fondi bëhet sipas përcaktimeve në nenin 61, të ligjit nr.7703 datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Shpenzimet administrative, si pjesë e shpenzimeve totale për skemën e sigurimeve shoqërore, janë jo më shumë se 2 618 milionë lekë dhe janë të ndara sipas skemave, në proporcion me shpenzimet e drejtpërdrejta.

#### Neni 5

Buxheti i sigurimeve shëndetësore për vitin 2019 është:

Të ardhurat, gjithsej,	41 900 milionë lekë;
Nga të cilat:	
- kontributet dhe të tjera	13 729 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	28 171 milionë lekë;
Shpenzimet	41 900 milionë lekë.

Fondi për rimbursimin e medikamenteve nuk tejkalon tavanin prej 11 000 milionë lekësh, përfshirë edhe pagesën e detyrimeve të prapambetura. Fondi për shërbimin spitalor detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave.  
.....

#### Neni 8

Të ardhurat e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

Grantet	15 500 milionë lekë;
Të ardhurat tatimore	323 604 milionë lekë;
Të ardhurat jotatimore	22 840 milionë lekë.”.

#### Neni 2

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Shpenzimet e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

- Shpenzime të buxhetit qendror	387 195 milionë lekë;
- Fondi rezervë	2 000 milionë lekë;

- Fondi rezervë i sistemit të drejtësisë 1 350 milionë lekë
- Kontingjencë për risqet e borxhit 4 300 milionë lekë.”.

b) Tabelat 1 dhe 4, të përmendura në nenin 10, zëvendësohen, përkatësisht, me tabelat me të njëjtin numërtim, që i bashkëlidhen këtij akti normativ dhe janë pjesë përbërëse të tij.

### **Neni 3**

Në nenin 11 bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

- a) Numri i përgjithshëm i punonjësve në organikë bëhet 82 455 veta;
- b) Tabela 2, e përmendur në nenin 11, zëvendësohet me tabelën me të njëjtin numërtim, që i bashkëlidhet këtij akti normativ dhe është pjesë përbërëse e tij;
- c) Në paragrafin e parafundit hiqen fjalët “... me miratim paraprak të Kuvendit.”;
- ç) Në paragrafin e fundit, shuma “500 milionë lekë” bëhet “400 milionë lekë”.

### **Neni 4**

Neni 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

#### “Neni 13

Fondi rezervë i buxhetit, prej 2 000 milionë lekësh, përdoret nga Këshilli i Ministrave për raste të paparashikuara të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme.

Fondi rezervë i sistemit të drejtësisë përdoret:

- deri në 1 miliardë lekë, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për financimin e pagave të reja të magjistratëve;
- deri në 350 milionë lekë, nga Këshilli i Ministrave, për krijimin dhe funksionimin e institucioneve të sistemit të drejtësisë.

Kontingjenca për risqet e borxhit, prej 4 300 milionë lekësh, përdoret nga ministri i Financave dhe Ekonomisë për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në shpenzimet për interesa.

Shumat e shpërndara nga fondi rezervë i buxhetit, fondi rezervë i sistemit të drejtësisë dhe kontingjenca për risqet e borxhit shtojnë kufijtë e miratuar në tabelat 1 dhe 4, që përmenden në nenin 10, të këtij ligji.”.

## Neni 5

Aneksi 3, që përmendet në nenin 16, zëvendësohet me aneksin me të njëjtin numërtim, që i bashkëlidhet këtij akti normativ dhe është pjesë përbërëse të tij.

## Neni 6

Ky akt normativ hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

MINISTRI I FINANCAVE  
DHE EKONOMISË

ANILA DENAJ



## Akti Normativ nr.1 2019 - SIPAS MINISTRIVE TE LINJES DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE (ne 000/LEK)

Kodi	Emertimi i Institucionit / Programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale			Totali i Shpenzimeve Buxhetore
			Financim i Brendshem	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	
<b>1</b>	<b>Presidenca</b>	<b>242,000</b>	<b>6,000</b>	<b>0</b>	<b>6,000</b>	<b>248,000</b>
01120	Veprimtaria e Presidentit	242,000	6,000	0	6,000	248,000
<b>2</b>	<b>Kuvendi</b>	<b>1,108,560</b>	<b>180,000</b>	<b>0</b>	<b>180,000</b>	<b>1,288,560</b>
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	410,828	180,000	0	180,000	590,828
01120	Veprimtaria Ligjvënëse	697,732	0	0	0	697,732
<b>3</b>	<b>Kryeministria</b>	<b>490,000</b>	<b>200,000</b>	<b>330,000</b>	<b>530,000</b>	<b>1,020,000</b>
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	490,000	200,000	330,000	530,000	1,020,000
<b>5</b>	<b>Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</b>	<b>4,137,542</b>	<b>2,463,420</b>	<b>2,692,000</b>	<b>5,155,420</b>	<b>9,292,962</b>
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	386,292	5,000	0	5,000	391,292
04220	Signa ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	1,367,160	70,420	197,918	268,338	1,635,498
04240	Menaxhimi i infrastruktures së kullimit dhe ujërës	692,074	2,080,000	755,800	2,835,800	3,527,874
04250	Zhvillimi Rural duke mbësht. Prodh. Bujq. Bleg. Agroind dhe Market.	1,100,337	184,000	1,565,682	1,749,682	2,850,019
04860	Keshillimi dhe Informacioni Bujqësor	445,259	20,000	0	20,000	465,259
05470	Menaxhimi qendroreshëm i tokës bujqësore	18,500	0	0	0	18,500
04230	Mbështetje për Peshkimin	127,920	104,000	172,600	276,600	404,520
<b>6</b>	<b>Ministria e Infrastruktures dhe Energjisë</b>	<b>4,654,080</b>	<b>23,678,492</b>	<b>17,902,132</b>	<b>41,580,624</b>	<b>46,134,704</b>
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	615,200	13,000	0	13,000	628,200
04520	Transporti rrugor	1,879,270	15,125,100	7,348,132	22,473,232	24,352,502
04540	Transporti Detar	99,000	100,000	0	100,000	199,000
04550	Transporti Hekurudhor	420,900	153,500	754,000	907,500	1,328,400
04560	Transporti Ajror	15,210	19,000	0	19,000	34,210
06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	478,500	4,232,000	5,220,000	9,452,000	9,930,500
06220	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	500,000	1,961,272	700,000	2,661,272	3,161,272
04320	Mbështetje për Energjinë	102,900	1,697,000	3,660,000	5,357,000	5,459,900
04430	Mbështetje për Burimet Natyrore	159,500	128,000	0	128,000	287,500
04440	Mbështetje për Industrinë	254,000	90,000	0	90,000	344,000
06180	Planifikimi Urban	29,600	159,620	220,000	379,620	409,220
<b>10</b>	<b>Ministria e Financave</b>	<b>51,922,889</b>	<b>3,358,250</b>	<b>1,188,000</b>	<b>4,546,250</b>	<b>56,469,139</b>
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	757,050	464,623	318,919	783,542	1,540,592
01120	Menaxhimi i Shpenzimeve Publike	457,923	5,000	0	5,000	462,923
01130	Ekzekutimi i Pagesave të Ndryshme	357,000	157,452	0	157,452	514,452
01140	Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore	2,246,001	938,000	0	938,000	3,184,001
01150	Menaxhimi i të Ardhurave Doganore	3,254,597	472,227	76,437	548,664	3,803,261
01160	Lufta kundër Transaksioneve Financiare Jo-Ligjore	89,400	27,000	0	27,000	116,400
04130	Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	273,000	91,300	100,000	191,300	464,300
04160	Mbështetje për Mbrojt. e Tregut, Infrast. e Ciles. dhe Pron. Industr.	336,500	29,000	0	29,000	365,500
10220	Sigurimi Shoqëror	40,241,750	0	0	0	40,241,750
10550	Tregu i Punës	1,636,700	53,400	0	53,400	1,690,100
04170	Inspektimi në Punë	172,968	10,000	0	10,000	182,968
09240	Arsimi i Mesëm (profesional)	1,805,000	780,248	692,644	1,472,892	3,277,892
05190	Strehimi	295,000	330,000	0	330,000	625,000
<b>11</b>	<b>Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë</b>	<b>35,417,184</b>	<b>3,544,000</b>	<b>300,000</b>	<b>3,844,000</b>	<b>39,261,184</b>
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	725,042	72,000	0	72,000	797,042
09120	Arsimi Bazë (përfshirë parashkollorin)	21,081,500	1,720,000	0	1,720,000	22,801,500
09230	Arsimi i Mesëm (i përgjithshëm)	6,224,643	1,062,000	0	1,062,000	7,286,643
09450	Arsimi Universitar	6,817,999	340,500	100,000	440,500	7,258,499
09770	Fonde për Shkencën	350,000	99,500	200,000	299,500	649,500
08140	Zhvillimi i Sportit dhe Rinisë	218,000	250,000	0	250,000	468,000
<b>12</b>	<b>Ministria e Kulturës</b>	<b>1,462,013</b>	<b>905,000</b>	<b>30,000</b>	<b>935,000</b>	<b>2,397,013</b>
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	160,276	0	0	0	160,276
08220	Trashëgimia Kulturore dhe Muzete	518,337	5,000	30,000	35,000	553,337
08230	Arti dhe Kultura	783,400	900,000	0	900,000	1,683,400
<b>13</b>	<b>Ministria e Shëndetësisë</b>	<b>57,890,877</b>	<b>1,990,000</b>	<b>1,140,000</b>	<b>3,130,000</b>	<b>61,020,877</b>
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	382,732	25,550	0	25,550	408,282
07220	Sherbimet e Kujdesit Paresor	7,584,000	440,433	278,000	718,433	8,302,433
07330	Sherbimet e Kujdesit Dytësor	22,105,006	1,446,534	762,000	2,208,534	24,313,540
07450	Sherbimet e Shëndetit Publik	2,815,760	15,850	0	15,850	2,831,610
07460	Sherbimi Kombëtar i Urgjencës	301,000	20,098	0	20,098	321,098
10430	Perkujdesi Social	23,455,079	41,535	100,000	141,535	23,596,614
01190	Rehabilitimi i të Përdjekurve Politik	1,247,300	0	0	0	1,247,300
<b>14</b>	<b>Ministria e Drejtësisë</b>	<b>11,029,578</b>	<b>727,580</b>	<b>350,000</b>	<b>1,077,580</b>	<b>12,107,158</b>
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	370,444	138,300	350,000	488,300	858,744
03310	Ndihma Juridike	39,900	3,000	0	3,000	42,900
01120	Publikimet Zyrtare	40,260	38,000	0	38,000	78,260
01130	Mjekësia Ligjore	79,300	11,000	0	11,000	90,300
03440	Sistemi i Burgjeve	5,391,174	472,000	0	472,000	5,863,174
03350	Sherbimi i Përmbarimit Gjyqësor	139,300	10,000	0	10,000	149,300
01160	Sherbimet për çështjet e bërësimeve	10,700	200	0	200	10,900

## Akti Normativ nr.1 2019 - SIPAS MINISTRIVE TE LINJES DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE (ne 000/LEK)

Kodi	Emertimi i Institucionit / Programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale			Totali i Shpenzimeve Buxhetore
			Financim i Brendshem	Financim i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	
01180	Sherbimi i Kihimit dhe Kompensimit te Pronave	4,820,800	33,680	0	33,680	4,854,480
03490	Sherbimi i Proves	137,700	21,400	0	21,400	159,100
15	<b>Ministria e Puneve te Jashtme</b>	<b>2,757,500</b>	<b>153,000</b>	<b>220,000</b>	<b>373,000</b>	<b>3,130,500</b>
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	128,000	87,000	0	87,000	215,000
01120	Mbeshtetje diplomatike jashte shtetit	2,331,000	35,000	0	35,000	2,366,000
01130	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ	207,500	0	0	0	207,500
01150	Mbeshtetja Institucionale per Procesin e Integrimt	91,000	31,000	220,000	251,000	342,000
16	<b>Ministria e Brendshme</b>	<b>19,091,211</b>	<b>1,366,556</b>	<b>994,868</b>	<b>2,361,424</b>	<b>21,452,635</b>
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,168,000	131,100	0	131,100	1,299,100
03140	Policia e Shtetit	15,150,542	1,121,856	818,868	1,940,724	17,091,266
03150	Garda e Republikes	1,558,769	12,000	0	12,000	1,570,769
01160	Prefekurat dhe Funksionet e Deleguara te Pushtetit Vendor	518,900	88,600	176,000	264,600	783,500
01170	Sherbimi i Gjendjes Civile	695,000	13,000	0	13,000	708,000
17	<b>Ministria e Mbrojtjes</b>	<b>18,532,417</b>	<b>3,515,500</b>	<b>0</b>	<b>3,515,500</b>	<b>22,047,917</b>
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,185,000	30,000	0	30,000	1,215,000
02120	Forcat e Luftimit	5,113,407	2,887,500	0	2,887,500	8,000,907
09430	Arsimi Usharak	600,050	4,500	0	4,500	604,550
02150	Mbeshtetja e Luftimit	5,393,410	175,000	0	175,000	5,568,410
07340	Mbeshtetje per Shendetesine	885,550	70,500	0	70,500	956,050
10270	Mbeshtetje Sociale per Usharaket	5,060,000	0	0	0	5,060,000
10910	Emergencat Civile	295,000	348,000	0	348,000	643,000
18	<b>Sherbimi Informativ Shtetror</b>	<b>1,475,000</b>	<b>50,000</b>	<b>0</b>	<b>50,000</b>	<b>1,525,000</b>
03520	Veprimtaria Informative Shtetore	1,475,000	50,000	0	50,000	1,525,000
19	<b>Drejtoria e Radio Televizionit</b>	<b>572,000</b>	<b>50,000</b>	<b>0</b>	<b>50,000</b>	<b>622,000</b>
08310	Sherbimet per shqiptaret jashte kufirit	240,000	0	0	0	240,000
08520	Projekte teknike per futjen e teknologjive te reja	200,000	50,000	0	50,000	250,000
08330	Prodhime filmike ose veprimtari artistike mbarekombetare	72,000	0	0	0	72,000
08340	Orkestra simfonike e RTSH dhe Kinematografise	60,000	0	0	0	60,000
20	<b>Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave</b>	<b>176,000</b>	<b>85,000</b>	<b>0</b>	<b>85,000</b>	<b>261,000</b>
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	176,000	85,000	0	85,000	261,000
22	<b>Akademia e Shkences</b>	<b>106,040</b>	<b>2,000</b>	<b>0</b>	<b>2,000</b>	<b>108,040</b>
01520	Veprimtaria Akademike	106,040	2,000	0	2,000	108,040
24	<b>Kontrolli Larte i Shtetit</b>	<b>397,900</b>	<b>20,000</b>	<b>0</b>	<b>20,000</b>	<b>417,900</b>
01120	Veprimtaria Audituese e KLSH	397,900	20,000	0	20,000	417,900
26	<b>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit</b>	<b>1,283,840</b>	<b>629,000</b>	<b>515,000</b>	<b>1,144,000</b>	<b>2,427,840</b>
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	220,000	11,040	0	11,040	231,040
05320	Programe per mbrojtjen e Mjedisit	467,300	166,670	215,000	381,670	848,970
04260	Administrimi i Pyjeve	439,540	97,790	300,000	397,790	837,330
04760	Zhvillimi i Turizmit	157,000	353,500	0	353,500	510,500
28	<b>Prokuroria e Pergjithshme</b>	<b>1,620,000</b>	<b>130,000</b>	<b>0</b>	<b>130,000</b>	<b>1,750,000</b>
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,620,000	130,000	0	130,000	1,750,000
29	<b>Keshilli i Larte Gjyqsor</b>	<b>2,215,450</b>	<b>162,000</b>	<b>0</b>	<b>162,000</b>	<b>2,377,450</b>
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	94,450	2,620	0	2,620	97,070
03310	Buxheti Gjyqsor	2,121,000	159,380	0	159,380	2,280,380
30	<b>Gjykata Kushtetuese</b>	<b>110,700</b>	<b>4,000</b>	<b>0</b>	<b>4,000</b>	<b>114,700</b>
03320	Veprimtaria Gjyqsore Kushtetuese	110,700	4,000	0	4,000	114,700
31	<b>Agjensia Telegrafike Shqiptare</b>	<b>66,000</b>	<b>4,000</b>	<b>0</b>	<b>4,000</b>	<b>70,000</b>
08320	Veprimtaria Telegrafike e ATSH-se	66,000	4,000	0	4,000	70,000
40	<b>Partite Politike</b>	<b>200,000</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>200,000</b>
01110	Mbeshtetje per Partite Politike	190,000	0	0	0	190,000
01120	Mbeshtetje per Shoqatat	8,000	0	0	0	8,000
01130	Mbeshtetje per Organizatat e Vetereve me Status	2,000	0	0	0	2,000
41	<b>Institucionet e SPAK &amp; BKH</b>	<b>66,000</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>66,000</b>
03390	Veprimtaria e SPAK & BKH	66,000	0	0	0	66,000
50	<b>Instituti Statistikes</b>	<b>631,340</b>	<b>31,000</b>	<b>150,000</b>	<b>181,000</b>	<b>812,340</b>
01320	Veprimtaria Statistikore	631,340	31,000	150,000	181,000	812,340
55	<b>Shkolla e Magjistratures</b>	<b>170,700</b>	<b>8,000</b>	<b>0</b>	<b>8,000</b>	<b>178,700</b>
09820	Veprimtaria Arsimore	170,700	8,000	0	8,000	178,700
56	<b>Fondi i Zhvillimit Shqiptar</b>	<b>0</b>	<b>9,935,000</b>	<b>5,470,000</b>	<b>15,405,000</b>	<b>15,405,000</b>
06210	Programe Zhvillimi	0	6,635,000	5,470,000	12,105,000	12,105,000
06220	Infrastruktura Vendore dhe Rajonale	0	3,100,000	0	3,100,000	3,100,000
04230	Programi "100 Fshatrat"	0	200,000	0	200,000	200,000
57	<b>Qendra Kombetare e Kinematografise</b>	<b>168,120</b>	<b>1,000</b>	<b>25,000</b>	<b>26,000</b>	<b>194,120</b>
08220	Mbeshtetja e veprimtarise kinematografike	168,120	1,000	25,000	26,000	194,120
63	<b>Institucionet e sistemit te drejtesise</b>	<b>397,000</b>	<b>10,200</b>	<b>0</b>	<b>10,200</b>	<b>407,200</b>
03320	Veprimtaria e Inspektoriatit te Larte te Drejtesise	10,000	0	0	0	10,000
03330	Veprimtaria e rivleresimit kalimtar te magjistratit	187,600	4,000	0	4,000	191,600
03340	Veprimtaria e apelimit te rivleresimit kalimtar	134,300	4,700	0	4,700	139,000
03360	Veprimtaria e komisionerit publik	65,100	1,500	0	1,500	66,600

## Akti Normativ nr.1 2019 - SIPAS MINISTRIVE TE LINJES DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE (ne 000/LEK)

Kodi	Emertimi i Institucionit / Programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale			Totali i Shpenzimeve Buxhetore
			Financim i Brendshem	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	
66	Avokati i Popullit	123,100	2,000	0	2,000	125,100
03320	Sherbimi i avokate	123,100	2,000	0	2,000	125,100
67	Komisioneri per Mbikqyrjen e Sherbimit Civil	55,266	2,000	0	2,000	57,266
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	55,266	2,000	0	2,000	57,266
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	735,600	26,500	0	26,500	762,100
01610	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	135,600	26,500	0	26,500	162,100
01620	Zgjedhjet e pergjithshme dhe lokale	600,000	0	0	0	600,000
76	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave	139,700	3,000	0	3,000	142,700
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	139,700	3,000	0	3,000	142,700
77	Autoriteti i Konkurences	75,000	3,500	0	3,500	78,500
04120	Mbikqyrja e tregut & Garantimi i konkurences	75,000	3,500	0	3,500	78,500
82	Keshilli Kombetar i Kontabilitetit	11,520	1,000	0	1,000	12,520
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	11,520	1,000	0	1,000	12,520
87	Institucione te tjera Qeveritare	4,062,967	1,533,502	293,000	1,826,502	5,889,469
01320	Sherbime Qeveritare	200,000	55,000	0	55,000	255,000
01130	Sherbimi i Prokurimit Publik	81,850	3,000	0	3,000	84,850
01120	Sherbimi per diasporan	117,000	61,000	0	61,000	178,000
05640	Administrimi i Ujrave	93,580	16,500	93,000	109,500	203,080
03310	Sherbimi i Avokate Shtetore	183,000	2,000	0	2,000	185,000
01150	Sherbime te tjera	392,822	116,502	0	116,502	509,324
01140	e-Qeverisja	2,534,197	1,116,500	0	1,116,500	3,650,697
01330	Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administrates Publike	332,118	162,000	200,000	362,000	694,118
08480	Mbeshtetje per Kulture Fetare	128,400	1,000	0	1,000	129,400
88	Mbeshtetje per Shoqerine Civile	123,000	1,000	0	1,000	124,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	123,000	1,000	0	1,000	124,000
89	Komisioneri per te Drejten e Informimit dhe Mbrojtjen e te Dheneve Personale	68,700	16,000	0	16,000	84,700
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	68,700	16,000	0	16,000	84,700
90	Veprimtaria e komisionit te prokurimit publik	79,100	1,000	0	1,000	80,100
01110	Veprimtaria e komisionit te prokurimit publik	79,100	1,000	0	1,000	80,100
91	Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi	52,300	5,000	0	5,000	57,300
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	52,300	5,000	0	5,000	57,300
92	Instituti i Studimeve te Krimeve te Komunizmit	34,500	2,000	0	2,000	36,500
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	34,500	2,000	0	2,000	36,500
95	Autoriteti per te Drejten e Informimit	59,000	2,000	0	2,000	61,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	59,000	2,000	0	2,000	61,000



## Akti Normativ nr.1 2019 - NUMRI I PUNONJESVE BUXHETORE

Kod min	Emertimi i Ministrisë / Institucionit Buxhetor	AN1 2019
1	Presidenca	86
2	Kuvendi	405
3	Kryeministria	150
5	Ministria e Buqësisë dhe Zhvillimit Rural	1,929
6	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	1,004
10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	5,906
11	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	31,072
12	Ministria e Kulturës	1,002
13	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	4,257
14	Ministria e Drejtësisë	5,628
15	Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme	565
16	Ministria e Brendshme	14,279
17	Ministria e Mbrojtjes	8,866
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	998
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	139
22	Akademia e Shkencës	29
24	Kontrolli i Lartë i Shtetit	196
26	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	1,099
31	Agjensia Telegrafike Shqiptare	50
50	Instituti Statistikës	236
55	Shkolla e Magjistraturës	34
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	9
66	Avokati i Popullit	56
67	Komisioneri për Mbrojtjen dhe Shërbimit Civil	31
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	71
76	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave	70
77	Autoriteti i Konkurrencës	46
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	6
90	Komisioni i Prokurimit Publik	36
87	<b>Institucione të tjera Qeveritare</b>	<b>1,155</b>
	<i>Drejtoria Sigurimit të Informacionit Klasifikuar</i>	38
	<i>Agjencia e Prokurimit Publik</i>	44
	<i>Komiteti Shtetëror i Minoriteteve</i>	15
	<i>Inspektorati Qendror</i>	21
	<i>Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore</i>	82
	<i>Qendra kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit</i>	8
	<i>Agjencia për Diasporën</i>	15
	<i>Qendra Botimeve të Diasporës</i>	15
	<i>Agjencia për Hapje, Dialog dhe Bashkeqeverisje</i>	42
	<i>Agjencia e Zhvillimit të Territorit</i>	40
	<i>Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit</i>	44
	<i>Agjencia Autonome e Auditimit të Fondeve të BE</i>	21
	<i>Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit</i>	332
	<i>Agjencia Ofrit të Shërbimeve Publike (ADISA)</i>	175
	<i>Komiteti Shtetëror i Kulteve</i>	10
	<i>Departamenti i Administratës Publike</i>	61
	<i>Shkolla Shqiptare e Administratës Publike</i>	16
	<i>Autoriteti Kombëtar Certifikimit Elektronik/Sigurime Kibernetike</i>	17
	<i>Sekretariati Teknik i KEK</i>	6
	<i>Autoriteti Shtetëror Gjeohapsinor (ASIG)</i>	46
	<i>Avokatura e Shtetit</i>	107
88	Agjensia për mbështetjen e shoqërisë civile	16
89	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	37
91	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	34
92	Instituti i studimeve të krimeve të komunizmit	19
95	Autoriteti për të Drejtën e Informimit mbi dokumentet ish-sigurimit	40
	<b>Institucione të Sistemit të Drejtësisë</b>	<b>2,825</b>
28	Prokuroria e Përgjithshme	928
29	Këshilli i Lartë Gjyqësor	1,493
30	Gjykata Kushtetuese	62
35	Këshilli i Lartë i Prokurorisë	65
41	Institucionet e SPAK & BKH	100
63	Këshilli i Lartë i Drejtësisë	0
63	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit	64
63	Kolegji i Posacem i Apelit	43
63	Komisioneri Publik	30
63	Inspektorati i Lartë i Drejtësisë	40
	<b>Total punonjës buxhetore</b>	<b>82,381</b>
	<i>Rezervë për institucione të qeverisjes qendrore</i>	24
	<i>Rezervë për institucionet e drejtësisë</i>	50
	<b>Total numri i punonjësve</b>	<b>82,455</b>

> ANEKSI 3

**Fondi për Zhvillimin e Rajoneve dhe Programi për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale**

1. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve është një mekanizëm financiar konkurrues që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor.
2. Për vitin 2019, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përbëhet nga granti konkurrues për arsimin.
3. Shpërndarja e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve sipas projekteve kryhet nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve, i cili kryesohet nga Kryeministri dhe ka këtë përbërje:

1. Kryeministrin	Kryetar
2. Zëvendëskryeministrin	Zëvendëskryetar;
3. Ministrin e Financave dhe Ekonomisë	anëtar;
4. Ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	anëtar;
5. Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	anëtar;
6. Ministrin e Kulturës	anëtar;
7. Ministrin e Brendshëm	anëtar;
8. Kryetarin e Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar;
9. Kryetarin e Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar;
10. Kryetarin e Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;

Në mungesë të kryetarit të Komitetit, mbledhja drejtohet nga zëvendëskryetari.

4. Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve miraton:
  - a) Specifikimet, rregullat dhe kriteret për financimin e projekteve dhe ndarjen e grantit të arsimit;
  - b) Shpërndarjen e fondeve për financim për projekte të reja investimi;
5. Fondi i Zhvillimit të Rajoneve me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në proces. Pjesa e financimit të projekteve në proces vendoset në listën e investimeve të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në përputhje me ecurinë e projektit. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë mund të kërkojë rialokime midis projekteve të FZHR-së, sipas procedurave të miratuara për investimet publike.
6. Thirrjet për aplikim në Fondin e Zhvillimit të Rajoneve për vitin buxhetor mund të bëhen që në Nëntor të vitit paraardhës.
7. Fondi i Zhvillimit të Rajoneve nuk trashëgohet në vitin e ardhshëm, buxhetor.
8. Sekretariati teknik për grantin për arsimin ngrihet pranë Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve është një njësi pranë Kryeministrisë.
9. Subjektet aplikuese dhe zbatuese janë njësitë e vetëqeverisjes vendore. Komiteti miraton me vendim autoritetin kontraktor për zbatimin e projektit. Rregulla të hollësishme lidhur me raportimin e autoriteteve kontraktuese miratohen me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

## **Programi buxhetor për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale në Fondin Shqiptar të Zhvillimit**

1. Fondet për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale, të parashikuara si program buxhetor 2019-2021 në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, janë një mekanizëm financiar që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor. Autoriteti programues, kontraktues dhe zbatues është Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
2. Specifikimet, rregullat, kriteret për financimin e projekteve si dhe shpërndarja e Fondit për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale për financimin e projekteve të reja miratohen nga Këshilli Drejtues i Fondit Shqiptar të Zhvillimit.
3. Fondi Shqiptar i Zhvillimit administron nevojat dhe propozimet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, qendrore dhe aktorë të tjerë (përfshirë FSHZH dhe njësitë e zhvillimit rajonal të tij) që konsistojnë në projekte në interes dhe në funksion të zhvillimit lokal e rajonal, përfshirë edhe projekte zhvillimore me natyrë ekonomike, të zbatuara në partneritet midis FSHZH dhe njësive të vetëqeverisjes vendore dhe subjekte të tjera.
4. Nga fondi për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale, Fondi Shqiptar i Zhvillimit me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në proces me burim financimi ish-Fondin e Zhvillimit të Rajoneve-Infrastrukura Vendore dhe Rajonale. Pjesa e financimit të projekteve në proces vendoset në listën e investimeve të FSHZH-së, në përputhje me ecurinë e projektit. Fondi Shqiptar i Zhvillimit mund të kërkojë rialokime midis projekteve, sipas procedurave të miratuara për investimet publike.
5. Rregulla të hollësishme lidhur me funksionimin e të gjithë procesit të programimit, monitorimit dhe raportimit të ecurisë së zbatimit miratohen me vendim të Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar.



NR.PROT. 4886/1  
DATË 4.10. 2019

KUVENDIT  
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË  
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGACI



A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Engjell Agaci', is written over a circular official stamp. The stamp contains the text 'MINISTRITË E FINANCAVE DHE EKONOMISË' and 'QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE' around its perimeter.